

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

V E N D I M

NR. 170, datë 27.9.2019

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË
LARTË TË PROKURORISË PËR PERIUdhËN DHJETOR 2018- KORRIK 2019**

Bazuar në nenin 149/a gërma dh të Kushtetutës dhe nenit 181 të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” Këshilli i Lartë i Prokurorisë ,

V E N D O S I

1. Miratimin e raportit të veprimitarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për periudhën dhjetor 2018- korrik 2019.
2. Raporti i dërgohet Kuvendit të Shqipërisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KRYETARI
GENT IBRAHIMI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

RAPORT

MBI

**VEPRIMTARINË E KËSHILLIT TË LARTË TË
PROKURORISË PËR PERIUDHËN DHJETOR
2018-KORRIK 2019**

(Miratuar me Vendimin nr. 170, datë 27.09.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë)

PËRMBAJTJA

- **1. HYRJE**
- 1.1 Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe garancitë kushtetuese për pavarësinë, llogaridhënien, statusin dhe karrierën e Prokurorit në Republikën e Shqipërisë
- 1.2 Çështjet kryesore që analizohen në raport

- **2 RAPORTIM MBI VEPRIMTARINË E KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË PËR PERIUdhËN DHJETOR 2018- KORRIK 2019**
- 2.1 Krijimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kompetencat si dhe vendimmarrjet e para
- 2.1.1 Shpallja e vendeve vakante në Prokurorinë e Posaçme
- 2.1.2 Komandimi i prokurorëve si anëtarë të KLP
- 2.1.3 Caktimi i numrit të kandidatëve për prokurorë në Shkollën e Magjistraturës
- 2.1.4 Ftesa për shprehje interesi për pozicionin e pedagogut në Departamentin e Formimit Fillestar
- 2.1.5 Shpallja e fillimit të procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm
- 2.2 Seancat plenare
- 2.3 Akte nënligjore
- 2.4 Komisionet e përhershme të KLP-së
- 2.5 Veprimtaria e Komisioneve të përhershme
- 2.5.1 Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit
- 2.5.2 Komisioni Disiplinor
- 2.5.3 Komisioni i Vlerësimit të Veprimitarisë Etike dhe Profesionale
- 2.5.4 Komisioni i Zhvillimit të Karrierës
- 2.6 Marrëdhëniet e KLP-së me Shkollën e Magjistraturës
- **3 NGRITJA E PROKURORISË SË POSAÇME**
- 3.1 Njoftimi dhe shpallja e vendeve vakante
- 3.2 Procesi i hartimit dhe miratimit të Rregullores
- 3.3 Ngritja dhe përbërja e Komisionit të Posaçëm
- 3.4 Verifikimi i plotësimit të kushteve ligjore nga ana e kandidatëve dhe miratimi i listës zyrtare
- 3.5 Njoftimi dhe komunikimi me kandidatët zyrtarë
- 3.6 Takimi me kandidatët dhe çështjet e diskutuara
- 3.7 Metodologjia e miratuar me Urdhër të Kryetarit të Komisionit
- 3.8 Takimet e punës së Komisionit të Posaçëm
- 3.9 Mënyra e vlerësimit të kandidatëve sipas nenit 9, të Rregullores
- 3.10 Mënyra e vlerësimit të kandidatëve sipas nenit 10, të Rregullores
- 3.11 Mënyra e vlerësimit të kandidatëve sipas nenit 5 dhe 6, të Rregullores
- 3.12 Dokumentacioni i administruar nga Komisioni
- 3.13 Vlerësimi përfundimtar i Komisionit dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë
- **4. PROCESI I PËRZGJEDHJES SË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**
- 4.1 Njoftimi dhe shpallja e vendeve vakante
- 4.2 Afatet e verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore nga ana e kandidatëve
- 4.3 Kërkimi i informacionit për verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore nga ana e kandidatëve
- **5. KONKLUZIONE**

1 HYRJE

1.1 KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË DHE GARANCITË KUSHTETUESE PËR PAVARËSINË, LLOGARIDHËNIEN, STATUSIN DHE KARRIERËN E PROKURORIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në vitin 2016, Kuvendi i Shqipërisë miratoi një reformë rrënjësore dhe gjithëpërfshirëse kushtetuese dhe ligjore për organizimin dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë. Shkaqet kryesore të kësaj reforme lidheshin me praninë e fenomeneve negative të korrupsionit, ndikimit politik, mungesës së profesionalizimit, eficiencës, transparencës, mungesës së aksesit në drejtësi, etj., të cilat kanë shkaktuar mungesën e dhënien së drejtësisë dhe uljen e besimit të shtetasve.

Degradimi i sistemit të drejtësisë, në mënyrë zinxhir, kishte krijuar kushtet për zhvillimin e fenomeneve negative dhe përkeqësimin e funksionimit të institucioneve të tjera shtetërore, të lidhura direkt apo indirekt me të, duke dobësuar ndjeshëm Shtetin e së Drejtës, kishte çuar në shkelje të rënda të të drejtave dhe lirive të shtetasve, cënimin e sigurisë publike me pasoja të rënda për shoqërinë, uljen e potencialit për tërheqjen e investimeve të huaja, etj.

Për këtë, reforma në drejtësi nisi me ndryshimet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe u pasua me miratimin e disa ligjeve të posaçme, të cilët ndryshuan në mënyrë thelbësore organizimin dhe funksionimin e institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë. Si rezultat i këtyre ndryshimeve, u krijua Këshilli i Lartë i Prokurorisë (më tej, KLP), si organ që qeveris sistemin e prokurorisë, bazuar në parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe të eficiencës¹.

Sistemi i drejtësisë, përmes institucioneve që e përbëjnë atë, duhet të sigurojë zbatimin e parimeve kushtetuese se, *të gjithë janë të barabartë përpara ligjit* dhe se, *sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor*².

Legjislacioni i mësipërm rregullon organizimin dhe funksionimin e të gjithë organeve që përbëjnë sistemin e drejtësisë duke vendosur garancitë e nevojshme ligjore për *pavarësinë, llogaridhënien, transparencën dhe të eficiencën* e këtyre organeve në dhënien e drejtësisë njësoj për të gjithë shtetasit pa dallim, për shkak të funksionit shtetëror apo pozitës sociale.

Cilësia e dhënies së drejtësisë është tregues i funksionimit të organeve që përbëjnë sistemin e drejtësisë ,ku bën pjesë edhe Prokuroria, dhe njëkohësisht ndikon në krijimin e besimit të shtetasve tek ky sistem si dhe veprimtarinë e institucioneve të tjera

¹ Neni 2, i Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

² Nenet 7 dhe 18/1, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

ligjzbatuese dhe profesioneve të lira si, Policia e Shtetit, Shërbimi i Provës, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Avokatia, etj.

Kuadri i ri ligjor ka vendosur garanci të mira për ushtrimin e detyrës së prokurorit në mënyrë të pavarur dhe efikase. Përveç respektimit të parimeve të ligjshmërisë, objektivitetit, paanshmërisë dhe zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme të prokurorit më të lartë, veprimtaria e Prokurorisë duhet të ushtrohet duke respektuar garancitë sa i takon pavarësisë dhe autonomisë së nevojshme të prokurorëve për marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit të funksionit të tyre kushtetues dhe ligjor nga çdo ndikim i paligjshëm, i brendshëm apo i jashtëm, nga çdo autoritet publik apo privat.

Përveç pavarësisë procedurale të Prokurorëve gjatë hetimit dhe përfaqësimit të akuzës në gjyq, ligji garanton të drejtën e prokurorëve për të kundërshtuar udhëzimet e përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm apo drejtuesit të prokurorive, nëse vlerësojnë se ato janë të paligjshme apo të pabazuara.

Në respekt të parimeve të ligjshmërisë dhe procedimit të drejtë dhe të barabartë, ligji rregullon edhe procedurën e zëvendësimit të prokurorit dhe të drejtën e ankimit në KLP, ndaj vendimit për zëvendësimin e tij në një çështje penale, nga drejtuesi i Prokurorisë.

Shqipëria, si vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Europian u angazhua për ndërmarrjen e reformave që lidhen me BE-në dhe veçanërisht, në trajtimin e 5 prioritetëve kyçe të identifikuar për hapjen e negociatave për anëtarësim si: lufta ndaj krimit në përgjithësi dhe atij të organizuar në veçanti, lufta kundër korrupsionit, krijimi i një administrate publike të kualifikuar dhe të depolitizuar, përmirësimi i veprimtarisë dhe forcimi i pavarësisë së pushtetit gjyqësor, si dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut.

Në **Raportin e Progresit të vitit 2015, të Bashkimit Europian**³ për Shqipërinë, janë evidentuar në mënyrë të përmbledhur mangësitë kryesore të sistemit të drejtësisë si: mungesa e pavarësisë dhe besueshmërisë së gjykatësve dhe prokurorëve, mosekzekutimi i vendimeve, bashkëpunimi i dobët ndërinstucional dhe vonesat në administrimin e drejtësisë. Besimi ndaj gjykatësve dhe prokurorëve është i pamjaftueshëm, dhe korrupsioni në sistemin e drejtësisë është i përhapur gjerësisht. Edhe pse sanksionohet në Kushtetutë, në praktikë pavarësia e gjyqtarëve dhe prokurorëve është e kufizuar dhe ka raportime të rregullta për drejtësi selektive dhe ndërhyrje politike në çështjet gjyqësore. Përsa i takon eficiencës, Shqipëria ka proceset civile dhe penale më të gjata në Europë. Procedurat për emërimin, ngritjen në detyrë dhe shkarkimin e stafit kyç në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm karakterizohen nga mungesa e transparencës, etj.

Në **Raportin për vitin 2018 të Bashkimit Europian**, Shqipërisë i kërkohet të ndërmarrë veprime të mëtejshme për të forcuar pavarësinë, eficiencën dhe llogaridhënien e institucioneve të drejtësisë. Tiparet kryesore të reformës në vazhdim mund të

³ Konstatime të ngjashme pasqyrohen dhe në Raportin për vitin 2016, të Bashkimit Europian për Shqipërinë.

përmbliidhen në shtyllat e mëposhtme: masat për të luftuar korrupsionin, përfshirë edhe krijimin e Prokurorisë së Posaçme dhe Njësisë së Posaçme Hetimore (SPAK); masat për të reduktuar influencën e parlamentit dhe ekzekutivit në gjyqësor; masat për të rritur pavarësinë, paanshmërinë dhe transparencën e Këshillave të Lartë Gjyqësor (më tej KLGJ) dhe të Prokurorisë; masat për të rritur llogaridhënien e gjyqtarëve dhe prokurorëve përmes krijimit të KLGJ-së dhe KLP-së si dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; masat për të rritur eficiencën e drejtësisë dhe aksesin në drejtësi.

Në këtë Raport, Shqipërisë i është kërkuar të bëjë përpjekje të vendosura për krijimin e një historiku të qëndrueshëm të hetimeve, ndjekjeve penale proaktive dhe dënimeve, në luftën kundër korrupsionit dhe në luftën kundër krimit të organizuar.

Ndërsa, në **Raportin mbi Praktikën për të Drejtat e Njeriut për vitin 2018 për Shqipërinë, të Departamentit Amerikan të Shtetit**, konstatohet se presioni politik, kërcënimet, korrupsioni i gjerë dhe burimet e kufizuara, ndonjëherë e pengojnë sistemin gjyqësor për të punuar në mënyrë të pavarur dhe eficiente. Ndërsa prokurorët arritën progres domethënës duke ndjekur raste të korrupsionit në nivel të ulët të zyrtarëve, ndjekjet penale për krimet më të rënda ishin të rralla për shkak të frikës së hetuesve nga ndëshkimi, mungesës së përgjithshme të burimeve dhe korrupsionit të sistemit gjyqësor.

Luftimi efikas i korrupsionit dhe krimit të organizuar është kusht i domosdoshëm për forcimin e Shtetit të së Drejtës, respektimin e të drejtave themelore të njeriut, si dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

1.2 ÇËSHTJET KRYESORE QË ANALIZOHEN NË RAPORT

Sikurse u trajtua më sipër, KLP është një nga institucionet e reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, i cili u krijua në kuadër të reformës në drejtësi, pas ndryshimeve në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe miratimit të ligjeve të posaçme që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e organeve që përbëjnë sistemin e drejtësisë.

Në këtë raport, që përfshin periudhën dhjetor 2018-korrik 2019 jepet informacion i detajuar mbi veprimtarinë e KLP-së, duke patur parasysh vonesën e krijuar për ngritjen dhe funksionimin e këtij institucioni, në përputhje me parashikimet ligjore.

Në periudhën objekt raportimi, në mënyrë të përmbledhur, KLP ka trajtuar çështje që lidhen kryesisht me:

- a) rregullimin e veprimtarisë së KLP-së;
- b) mirëadministrimin e prokurorive nëpërmjet rregulloreve të ndryshme si, rregullorja “Për veprimtarinë jashtë funksionit të prokurorëve”, “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”, “Për pagesat e prokurorëve jashtë afatit zyrtar” etj.;

- c) statusin e prokurorëve duke përfshirë nisjen e procesit të emërimit të magistratëve të rinj, nisjen e procedurës së krijimit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (këtej e tutje, Prokuroria e Posaçme), mbarimin e statusit të magistratit për shkak të daljeve në pension, përfundimit të mandatit, dorëheqjeve, etj.

Në raport informohet mbi veprimtarinë e realizuar nga Komisionet e Përherhshme të KLP, aktet nënligjore të miratuara nga KLP-ja, marrëdhëniet me Shkollën e Magjistraturës, etj. Vend të veçantë në këtë raport zë edhe informacioni i detajuar mbi procesin e përzgjedhjes së prokurorëve për Prokurorinë e Posaçme.

Po kështu, në raport informohet lidhur me procesin e përzgjedhjes së Prokurorit të Përgjithshëm dhe verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore. Më parë, KLP miratoi Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm”, me mbështetjen e misioneve OPDAT dhe EURALIUS.

2 RAPORTIM MBI VEPRIMTARINË E KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË PËR PERIUDHËN DHJETOR 2018- KORRIK 2019

2.1 KRIJIMI I KLP-SË, KOMPETENCAT SI DHE VENDIMMARRJET E PARA

Neni 149, i Kushtetutës parashikon se, KLP është organ kolegjal i përbërë nga 11 anëtarë, nga të cilët 6 anëtarë zgjidhen nga radhët e prokurorëve të të gjitha niveleve dhe 5 anëtarë zgjidhen nga Kuvendi midis radhëve të juristëve.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë zhvilloi mbledhjen e tij të parë më datë 19.12.2018. Në mbledhje morën pjesë 11 anëtarë. Mbledhja u drejtua nga anëtari jomagjistrat më i vjetër në moshë, Znj. Nurihan Seiti, në përputhje me nenin 280, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Në mbledhjen e parë konstitutive, KLP zgjodhi kryetar Z. Gent Ibrahimi dhe zëvendëskryetar të Këshillit Z. Alfred Balla.

Gjithashtu u hodh shorti për kohëzgjatjen e mandatit të anëtarëve të Këshillit, i cili rezultoi si më poshtë:

- | | |
|-------------------------|--------|
| - Z. Gent Ibrahimi | 3 vjet |
| - Z. Sandër Beci | 3 vjet |
| - Znj. Antoneta Sevdari | 3 vjet |
| - Z. Arben Dollapaj | 3 vjet |

Anëtarët e tjerë të KLP-së, Z. Kostaq Beluri (3 vjet), Z. Bujar Sheshi, Znj. Nurihan Seiti, Z. Alfred Balla dhe Z. Tartar Bazaj kanë mandat 5-vjeçar.

KLP, prej momentit të krijimit, duke u bazuar në dispozitat kushtetuese dhe ligjore, është kompetente për karrierën në tërësi të prokurorëve. Kështu, në Nenin 149/a të Kushtetutës, përcaktohet se, KLP:

- a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon prokurorët e të gjitha niveleve;*
- b) vendos për masat disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve;*
- c) i propozon Kuvendit kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm, sipas ligjit;*
- ç) miraton rregullat për etikën e prokurorëve dhe mbikëqyr respektimin e tyre;*
- d) propozon dhe administron buxhetin e tij;*
- dh) informon publikun dhe Kuvendin mbi gjendjen e prokurorisë;*
- e) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.”*

Gjithashtu, Neni 159, i Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ndër të tjera, përcakton në mënyrë më të detajuar kompetenca të tjera si:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë organizohet dhe e ushtron veprimtarinë e tij në mbledhje plenare ose në komisione.
2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë në mbledhjen plenare ushtron kompetencat e mëposhtme:
 - a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon prokurorët e të gjitha niveleve;
 - b) vendos masa disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve;
 - c) i propozon Kuvendit kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - ç) miraton rregullat për etikën e prokurorëve dhe mbikëqyr respektimin e tyre;
 - d) propozon dhe administron buxhetin e tij;
 - dh) informon publikun dhe Kuvendin për gjendjen e prokurorisë;
 - e) miraton akte nënligjore normative, në zbatim të këtij ligji ose të ligjeve të tjera, me ndikim të përgjithshëm detyruës për të gjithë prokurorët;
 - ë) miraton aktet për rregullimin e procedurave të brendshme të Këshillit;
 - f) miraton Kodin e Etikës së Këshillit;
 - g) shqyrton, sipas rastit, vendimet e komisioneve;
 - gj) miraton udhëzime jodetyruese;
 - h) miraton rregullat e hollësishme për funksionimin e administratës së Këshillit;
 - i) miraton përbërjen e komisioneve të përhershme, të komisioneve të përkohshme, si dhe rregulla të detajuara për funksionimin e tyre...

2.1.1 Shpallja e vendeve vakante në Prokurorinë e Posaçme

Menjëherë pas krijimit të tij dhe në ushtrim të këtyre kompetencave kushtetuese dhe ligjore, në muajin Janar 2019, KLP shpalli fillimin e procedurave për plotësimin e 15 (pesëmbëdhjetë) pozicioneve vakante në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (më tej, Prokuroria e Posaçme). Për shkak të numrit të ulët të kandidaturave që shprehën interes në thirrjen si dhe me qëllim konkurrencën dhe për zgjedhjen e kandidatëve më të mirë, KLP vendosi të shtyjë afatin e pranimit të aplikimeve për këto pozicione.⁴

2.1.2 Komandimi i prokurorëve si anëtarë të KLP

Në përputhje me nenin 53/2, të Ligjit nr. 96/2016, “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenin 176/3, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, KLP ftoi të gjithë prokurorët e shkallës së parë dhe të dytë, të cilët nuk shërbenin në një pozicion me mandat të kufizuar dhe që nuk ishin të komanduar në ndonjë pozicion tjetër, të shprehnin interesin për t’u komanduar në pozicionin e Këshilltarit pranë KLP-së. Në përputhje me procedurat ligjore, fillimisht u komanduan 6 prokurorë.

⁴ Vendim nr. 10/1, datë 07.01.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

2.1.3 Caktimi i numrit të kandidatëve për prokurorë në Shkollën e Magjistraturës

Në zbatim të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, KLP caktoi numrin e kandidatëve për prokurorë në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2019-2020.⁵

2.1.4 Ftesa për shprehje interesi për pozicionin e pedagogut në Departamentin e Formimit Fillestar

Në përputhje me nenet 53 dhe 54, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenin 264 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 6 datë 29.01.2019, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, KLP ftoi të gjithë prokurorët që plotësonin kriteret ligjore, të shprehnin interesin për pozicionin e pedagogut të brendshëm, në departamentin e Formimit Fillestar, pranë Shkollës së Magjistraturës, përmes procedurës së komandimit.

2.1.5 Shpallja e fillimit të procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm

Në muajin mars 2019, KLP, bazuar në nenin 148/a, paragrafi 3 të Kushtetutës, Seksionit I dhe II të Kreut IV, të Ligjit 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, shpalli fillimin e procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm, përmes procedurës së hapur të thirrjes publike për aplikim, bazuar në Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm”, të miratuar nga KLP.

2.2 SEANCAT PLENARE

Që nga momenti i zhvillimit të mbledhjes së tij të parë dhe deri më datë 31 korrik 2019, KLP duhet jo vetëm të ngriej si institucion, por edhe t'i përgjigjej sa më shpejt detyrimeve ligjore.

Deri më tani, KLP ka zhvilluar 24 mbledhje plenare dhe janë marrë 160 vendime, të cilat kanë pasur në fokus:

- a) rregullimin e veprimtarisë së KLP-së;
- b) mirëadministrimin e prokurorive nëpërmjet rregulloreve të ndryshme si: rregullorja “Për veprimtarinë jashtë funksionit të prokurorëve”, “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”, “Për pagesat e prokurorëve jashtë afatit zyrtar” etj.

⁵ Vendim nr. 21, datë 28.01.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

- c) statusin e prokurorëve, duke përfshirë nisjen e procesit të emërimit të magistratëve të rinj, nisjen e procedurës së krijimit të Prokurorisë së Posaçme, mbarimin e statusit të magistratit për shkak të daljeve në pension, përfundimin e mandatit, dorëheqjeve, etj.

Pas zgjedhjes së organeve drejtuese, të kryetarit dhe të zëvendëskryetarit, si dhe të anëtarëve, të cilët do të ushtrojnë detyrën me mandat 3-vjeçar, vlen të theksojmë se, përgjatë kësaj periudhe, KLP ka miratuar 6 vendime të karakterit nënligjor, ashtu sikurse vendime të tjerë, të cilët kanë të bëjnë me ngritjen dhe përbërjen e Komisioneve të përhershme dhe të Komisioneve të përkohshme.

Disa nga çështjet me të cilat u përball KLP, të cilat kërkonin ndërhyrje të menjëhershme, paraqiten më poshtë:

- a) Vakuumi në sistemin e drejtimit në prokuroritë, si pasojë e shkarkimit të drejtuesve të prokurorive gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar;
- b) Nisja e procesit të krijimit të Prokurorisë së Posaçme;
- c) Nisja e procesit të emërimit dhe caktimi në detyrë i magistratëve, të cilët kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018 dhe pranimet e reja në Shkollën e Magjistraturës për vitin 2019-2020;
- ç) Ngritja e strukturës përkatëse për vijimin e bashkëpunimit me institucionet e rivlerësimit kalimtar;
- d) Ngritja e Komisioneve të përhershme dhe Komisioneve të përkohshme, sipas parashikimeve ligjore, si një domosdoshmëri për të shqyrtuar çështje të veçanta;
- dh) Ngritja e një strukture të mirëorganizuar në shërbim të Këshillit dhe Komisioneve;
- e) Nisja e procedurave për përzgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm.

2.3 AKTE NËNLIGJORE

Në mbështetje të neneve 149 dhe 179/6, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 280, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të Vendimit nr. 19/2018, “Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, dhe të Vendimit datë 11.12.2018, të Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve “Për rezultatin e zgjedhjeve dhe shpalljen e fituesve”, me Vendimin nr. 1, datë 19.12.2018, “Për krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, anëtarët e KLP-së deklaruan krijimin e Këshillit, bazuar në vlerat e pavarësisë, llogaridhënies, meritokracisë, integritetit dhe profesionalizmit.

Me Vendimin nr. 2, datë 19.12.2018, të KLP është miratuar Rregullorja “Për procedurën e zgjedhjes së kryetarit dhe zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”. Ndërsa, me Vendimin nr. 3, datë 19.12.2018, të KLP, janë zgjedhur kryetari dhe zëvendëskryetari i këtij Këshilli. Me Vendimin nr. 6, dt. 19.12.2018, të KLP është miratuar përbërja e Komisioneve të përhershme pranë këtij Këshilli. Ndërsa, me Vendimin nr. 10, dt. 7.1.2019, KLP ka vendosur fillimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës

së kandidatëve për prokurorë, të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2017-2018.

KLP ka miratuar Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”⁶, rregullore e cila ka për qëllim përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për ngritjen në detyrë të prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme, bazuar në një proces objektiv, transparent dhe gjithëpërfshirës, me synim aftësimin për të ushtruar funksionet e saj në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe efektive.

KLP ka miratuar Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë”⁷, rregullore në të cilën janë përcaktuar kriteret dhe procedurat që lejojnë Këshillin të kryejë një proces objektiv, transparent, dhe gjithëpërfshirës për përzgjedhjen, renditjen dhe propozimin e tre kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm. Procesi i vlerësimit dhe përzgjedhjes do të bazohet dhe do të respektojë parimin e drejtësisë, barazisë dhe mosdiskriminimit.

KLP ka ngritur një Komision të Posaçëm për vlerësimin e kandidatëve për Prokurorinë e Posaçme. Ai ka miratuar “Metodologjinë e punës së Komisionit të Posaçëm për vlerësimin e kandidatëve për Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, me qëllim që të lehtësojë punën e Komisionit në zbatim të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, për të siguruar një proces objektiv, transparent dhe gjithëpërfshirës.

Në mbështetje të nenit 143, të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, të nenit 9, të Ligjit Nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 34, datë 10.04.2017, të Gjykatës Kushtetuese dhe nenit 189/1/c, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së shtetit të drejtësisë”, i ndryshuar, KLP ka miratuar Rregulloren “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”⁸, e cila përcakton rregulla të detajuara që lidhen me aktivitetin e prokurorit jashtë funksionit.

KLP ka miratuar Rregulloren “Për vlerësimin etik dhe profesional të subjekteve në procesin e rivlerësimit”⁹, si dhe rregullat për kryerjen e praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës.

Bazuar në nenin 59, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, KLP ka miratuar Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”¹⁰, rregullore në të cilën janë përcaktuar parimet, kriteret dhe procedurat për caktimin e përkohshëm të prokurorëve në pozicione të përkohshme, të krijuara në

⁶ Vendim nr. 51, datë 29.3.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

⁷ Vendim nr. 50, datë 19.03.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

⁸ Vendim nr. 26, datë 22.02.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

⁹ Vendim nr. 45, datë 19.03.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

¹⁰ Vendim nr. 64, datë 15.04.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

sistemin e prokurorisë. Procedura e caktimit të përkohshëm kryhet në përputhje me parimin e ligjshmërisë, objektivitetit, eficiencës dhe transparencës.

KLP ka miratuar Rregulloren “Për pagesat e prokurorëve për punën e kryer jashtë orarit zyrtar”¹¹, e cila ka vendosur rregulla të detajuara për kompensimin financiar, ose në ditë pushimi që duhet të marrin sipas ligjit magjistratët prokurorë, të cilët punojnë jashtë orarit zyrtar, ditët e pushimeve dhe festave zyrtare për shkak të shërbimit të gatishmërisë, masave të sigurimit apo çdo rasti tjetër sipas nevojave të funksionit që buron nga parashikimet e Kodit të Procedurës Penale apo ligje të tjera.

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 159 dhe 178, pika 2, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së shtetit të drejtësisë”, i ndryshuar, KLP ka miratuar strukturën organizative të administratës së Këshillit.¹²

2.4 KOMISIONET E PËRHERSHME TË KLP-SË

KLP është i organizuar në katër komisione të përhershme, si vijon:

Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit i cili kryesohet nga Kryetari i Këshillit Z. Gent Ibrahimi dhe ka në përbërje të tij: Znj. Nurihan Seiti dhe Z. Vatë Staka (i cili ka zëvendësuar znj. Antoneta Sevdari). Anëtarë zëvendësues të këtij komisioni janë: Z. Arben Dollapaj dhe Z. Alfred Balla.

Komisioni Disiplinor kryesohet nga Z. Bujar Sheshi dhe ka në përbërje të tij: Z. Besnik Cani dhe Z. Tartar Bazaj. Anëtarë zëvendësues të këtij komisioni janë: Znj. Nurihan Seiti dhe Z. Gentian Osmani.

Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale kryesohet nga Z. Alfred Balla dhe ka në përbërje të tij: Z. Kostaq Beluri dhe Z. Gentian Osmani. Anëtarë zëvendësues të këtij komisioni janë: Z. Besnik Cani dhe Z. Tartar Bazaj.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës kryesohet nga Z. Sandër Beci dhe ka në përbërje të tij: Z. Arben Dollapaj dhe Z. Vatë Staka (i cili ka zëvendësuar Znj. Antoneta Sevdari). Anëtarë zëvendësues të këtij komisioni janë: Z. Bujar Sheshi dhe Z. Gent Ibrahimi.

2.5 VEPRIMTARIA E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME

2.5.1 Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit

Bazuar në nenin 160, pika 3/a, të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së shtetit të drejtësisë”, i ndryshuar, ky Komision i ka propozuar mbledhjes plenare të KLP-së, marrjen e vendimeve në lidhje me buxhetin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore si për vitin 2019,

¹¹ Vendim nr. 91, datë 13.05.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

¹² Vendim nr. 36, datë 06.03.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

ashtu edhe në kuadrin e përgatitjes së projektbuxhetit afatmesëm. Kështu, Komisioni gjatë këtij viti i propozoi mbledhjes plenare të Këshillit marrjen e vendimeve në lidhje me:

- a) Buxhetin e vitit 2019 dhe strukturën organizative përkatëse;
- b) Miratimin e kërkesave buxhetore në fazën e planifikimit strategjik;
- c) Miratimin e kërkesave buxhetore në fazën teknike të projektbuxhetit afatmesëm.

Mbi bazën e këtyre propozimeve, KLP ka marrë vendimet përkatëse, të cilët u janë adresuar strukturave përkatëse të Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave.

Siç edhe e theksuam më parë, KLP u konstituua më 19 dhjetor 2018 dhe kësisoj, për këtë vit nuk rezultoi të ketë implikime buxhetore. Ndërkohë, Këshilli nuk kishte një buxhet të miratuar as për vitin 2019 dhe as burimet njerëzore mbështetëse, për rrjedhojë, veprimtaria funksionale e Këshillit nuk mund të ishte e plotë. Në këto rrethana, Komisioni i Planifikimit Strategjik dhe Buxhetit, me mbështetjen e një stafi të kufizuar specialistësh, ndërmori punën për përgatitjen e buxhetit të vitit 2019, punë e cila u finalizua me Vendimin e KLP, i cili iu përcoll Kuvendit të Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Sipas këtij Vendimi, kërkesat buxhetore të KLP-së, për vitin 2019, llogariteshin në 205 milion lekë, me një numër prej 75 punonjësish. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi një numër prej 65 punonjësish dhe Këshilli i Ministrave bazuar në këtë Vendim, alokoi një buxhet vjetor prej 108 milionë lekë për periudhën shtatë mujore, duke filluar efektet financiare më 1 Qershor 2019. Për periudhën deri në miratimin e buxhetit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë bëri një zgjidhje teknike provizore për pagat dhe sigurimet shoqërore, duke i përballuar këto shuma nga buxheti i Prokurorisë së Përgjithshme.

Duhet thënë që në fillim se, ky buxhet nuk parashikohet të ekzekutohet tërësisht gjatë vitit 2019 dhe kjo, jo për shkak se ai është i mjaftueshëm, por për shkaqe të tjera që lidhen me vënien në efciensë të plotë të KLP-së. Deri në këto momente, KLP dhe stafi mbështetës ka punuar me një mungesë të theksuar mjediseshe dhe ka në dispozicion disa zyra pune, të lëshuara përkohësisht nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria e Apelit Tiranë. Zgjidhja e mundësuar nga Këshilli i Ministrave për vendosjen e KLP-së në ndërtesën e “Polit të Drejtësisë” është pa dyshim një zgjidhje efikase, por e vonuar, gjë e cila ka cënuar veprimtarinë normale të këtij institucioni.

Procesit të hartimit dhe miratimit të buxhetit të vitit 2019, i parapriu një punë sistematike e kryer me asistencën e Departamentit të Administratës Publike, në lidhje me klasifikimin dhe kategorizimin e pagave të punonjësve të shërbimit civil dhe ndërtimit të organigramës së institucionit. Ndërkohë, implementimi kësaj strukture rezultoi një ushtrim i vështirë sa për shkak të procedurave të njohura për rekrutimin e punonjësve të shërbimit civil, por edhe për faktin se, rekrutimi i punonjësve është i lidhur drejtpërdrejtë me mungesën e mjediseve të punës, etj.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat e realizimit të buxhetit për periudhën Qershor-Korrik 2019 dhe projeksioni i vitit 2019.

REALIZIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2019							
							<i>Ne 000/lekë</i>
Nr	Zërat e shpenzimeve	Qershor-Korrik		Në %	Projeksioni vjetor		Në %
		Plan	Fakt		Plan	Fakt	
1	Paga	17 142	8 445	49,26	60 000	41 117	68,53
2	Sigurime shoqërore	2 285	726	31,77	8 000	4 535	56,69
3	Mallra e shërbime	5 714	509	8,908	20 000	20 000	100,00
4	Investime	-	-	-	20 000	20 000	100,00
	Totali	25 141	9 680	38,5	108 000	85 652	79,31

Nga pasqyra e mësipërme rezulton se, buxheti për periudhën qershor-korrik 2019 është realizuar vetëm në masën 38.5 %. Ky nivel i realizimit të buxhetit është i lidhur drejtpërdrejtë me faktin se, deri në këtë periudhë stafi mbështetës ishte kompletuar vetëm në masën 23 %, çka ka ndikuar në shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore.

Nga ana tjetër, mungesa e stafit ka ndikuar gjithashtu edhe në furnizimin e institucionit me mallrat e shërbimet e nevojshme për të realizuar funksionet e ngarkuara nga ligji, të cilat janë të lidhura me një seri procedurash administrative.

Deri në përfundim të vitit 2019, pritet të përmirësohet niveli i realizimit të buxhetit dhe sipas parashikimeve tona, ai do të arrijë në kuotën e 80 %, duke realizuar plotësisht zërat e investimeve, mallrave dhe shërbimeve.

Krahas përgatitjeve për vendosjen e stafit të KLP-së në mjediset e reja, është intensifikuar puna për përgatitjen dhe rekrutimin e stafit mbështetës. Në këtë kuadër, është bërë një kujdes i veçantë për hartimin e përshkrimeve të punës të stafit dhe përcaktimin e kriterëve për rekrutimin e tij, me synimin që të përzgjidhet një staf cilësor dhe me integritet të lartë moral dhe profesional. Në këtë drejtim është evidentuar si prioritet nevoja e rekrutimit të stafit mbështetës të Komisioneve, i cili parashikohet të ketë një impakt të drejtpërdrejtë në punën dhe eficiencën e Këshillit. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe Komisionet dhe Këshilli, me mbështetjen e EURALIUS, janë angazhuar në përgatitjen e rregullave dhe procedurave administrative për funksionimin e Këshillit, Komisioneve, si dhe të administratës.


Gjatë vitit 2019, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, me mbështetjen e stafit teknik, është angazhuar për përgatitjen e projektbuxhetit afatmesëm për vitin 2020-2022. Bazuar në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në Ligjin nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, janë përgatitur kërkesat buxhetore, të cilat janë bërë objekt i vendimmarrjes së Këshillit (pas përfundimit të fazës strategjike dhe teknike).

Kërkesat buxhetore të KLP, për vitin 2020-2022, janë dukshëm më të larta se tavanet buxhetore të parashikuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Kështu, tavanet buxhetore, për vitin 2020 parashikojnë një buxhet në shumën 169 milion lekë dhe një numër prej 65 punonjësish, ndërsa kërkesat buxhetore të KLP-së rezultojnë të jenë rreth 200 milion lekë ose 18.3 % më të larta, dhe një numër prej 83 punonjësish.

E parashtruar këtë fakt për të patur vëmendjen e shtuar të Kuvendit ndaj kërkesave buxhetore të KLP, pasi ato lidhen drejtpërdrejtë me zbatimin e reformës në drejtësi, ku KLP është një faktor i rëndësishëm. Theksojmë se, përkundër llogaritjeve të bëra nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë mbi bazën e buxhetit të këtij viti, i cili mendojmë se nuk është i vlefshëm për t'u marrë si referencë, kërkesat buxhetore të KLP-së janë rrjedhojë e kostimit të funksioneve të Këshillit, bazuar në ushtrimin e këtyre funksioneve gjatë vitit 2019 dhe të parashikimeve specifike në ligj.

Kështu, është parashikuar dhe ka dalë e domosdoshme të shtohen burimet njerëzore, për shkak të fluksit të madh të punës që ka ky institucion, të teknologjisë informacionit, por edhe të stafit mbështetës dhe të shërbimeve të Këshillit, veçanërisht personelit administrativ, për të siguruar mirëfunksionimin dhe eficiencën e plotë të Komisioneve dhe të Këshillit.

Nëse do t'i referohemi strukturës buxhetore sipas taveve buxhetore të parashikuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, rezulton se 70 % e buxhetit për KLP-në, e zënë pagat dhe sigurimet shoqërore. Pra, shpenzimet korente zënë 85 % të buxhetit, përkundrajt 15 % që zënë investimet. Ndërkohë, nevojat e këtij institucioni kërkojnë burime financiare suplementare për investime, pajisje, teknologji informative, trajnime, por edhe mallra e shërbime cilësore të cilat rrisin cilësinë dhe efikasitetin e punës së institucionit.



Këto çështje në mënyrë më të detajuar do t'i parashtrihen Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë gjatë diskutimit dhe konsultimeve që do të zhvillojmë për këtë qëllim, por edhe Komisionit përkatës të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ku shpresojmë të gjejmë mirëkuptimin për mbështetjen, ashtu si edhe deri më sot.

2.5.2 Komisioni Disiplinor

Me Vendimet nr. 41/2017 dhe nr. 78/2017, të Gjykatës Kushtetuese, u shfuqizuan disa dispozita të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", që kishin të bënin, ndër të tjera, me shkeljet disiplinore të anëtarëve të KLP-së, me mbledhjet plenare të KLP-së, si dhe me të drejtën e Ministrit të Drejtësisë për të marrë pjesë në mbledhjet e KLP.

Mangësitë e mësipërme ligjore u plotësuan me miratimin e Ligjit nr. 47/2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Këto ndryshime përmirësuan kuadrin ligjor përsa i takon shkeljeve disiplinore të anëtarëve të KLP sikurse u shtuan edhe tre nene të reja, në të cilat është bërë një ndarje e shkeljeve disiplinore, sipas natyrës së tyre në:

- a) shkelje disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit;
- b) shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit;
- c) shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së një vepre penale.

Me hyrjen në fuqi të këtyre dispozitave në muajin Gusht 2019, Komisioni Disiplinor do të vijojë punën efektivisht në ushtrim të funksioneve të ngarkuara nga ligji.

2.5.3 Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale

Në bazë të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, KLP është organi i ngarkuar për vlerësimin e punës të prokurorëve duke përfshirë edhe ndihmën në rivlerësimin kalimtar.

Para konstituimit të KLP-së, në bazë të nenit 160, pika 2, germa “d”, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Prokuroria e Përgjithshme ka qenë e ngarkuar si organ ndihmës në rivlerësimin kalimtar të prokurorëve, në bazë të Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Grupi i punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme, në bashkëpunim me anëtarët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (më tej, KPK), ka marrë pjesë në hedhjen e shortit për përzgjedhjen e pesë akteve dhe dosjeve hetimore që lidhen me këto akte, për 118 prokurorë, subjekte rivlerësimi. Nga Prokuroria e Përgjithshme janë përfunduar dhe janë dorëzuar në KPK, 83 raporte së bashku me materialet shoqëruese që kanë shërbyer për hartimin e këtyre raporteve.

Pas konstituimit të KLP-së, me Vendimin nr. 6, datë 26.12.2017, është krijuar “Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale”, i përbërë nga tre anëtarë (nga të cilët dy janë prokurorë dhe një jo prokuror) dhe dy anëtarë zëvendësues (një prokuror dhe një jo prokuror). Me krijimin e këtij komisioni, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme u bë kalimi i materialeve dhe dosjeve të papërfunduara për subjektet e rivlerësimit, në KLP.

Ndër detyrat kryesore të këtij Komisioni është vlerësimi i punës, si edhe përgatitja e raporteve të aftësive profesionale të prokurorëve, në kuadër të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Vlerësimi profesional i prokurorëve në kuadër të Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” përfshin periudhën tetor 2013 – tetor 2016. Procedura e vlerësimit profesional tre-vjeçar të prokurorëve, në

bazë të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, fillon në muajin nëntor 2019.¹³

Me Vendimin nr. 32, datë 22.02.2019, KLP vendosi të komandojë 6 magjistratë, prokurorë, për hartimin e draft-raporteve të vlerësimit profesional në kuadër të rivlerësimit.

KLP, në bashkëpunim me KPK, kanë organizuar shortet për përzgjedhjen në mënyrë rastësore, të pesë akteve dhe dosjeve, për 39 prokurorë pranë gjykatave të shkallës së parë Tiranë, Berat, Mat, Lushnjë Vlorë, Kurbin, Pogradec dhe Durrës.

Pas përzgjedhjes së akteve, KLP ka administruar formularin e vetëdeklarimit, 3 (tre) dokumente ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si edhe dokumente të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit. Janë administruar 5 (pesë) dosje penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, të cilat i janë venë në dispozicion KPK-së dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (më tej, ONM-së). Janë kërkuar dhe janë marrë të dhënat nga 23 Prokuroritë e rretheve gjyqësore, Drejtoria e Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative dhe Zyra e Informacionit të Klasifikuar, Sektori i Protokoll-Arkivit si dhe burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

Mbështetur në kriteret e përcaktuara në bashkëpunim me KPK-në si: aftësitë profesionale, aftësitë organizative, etika dhe angazhimi në veprimtari profesionale, dhe duke u bazuar në gjetjet në aktet e administruara, janë përgatitur raportet për analizimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit kalimtar.

Në përfundim, janë përgatitur dhe janë miratuar në seancë plenare nga KLP, 33 raporte për subjekte prokurorë, të cilat janë vënë në dispozicion të KPK-së dhe ONM-së.

Për periudhën janar-korrik 2019 janë përgatitur dhe janë miratuar raportet për 18 prokurorë kandidatë, që kanë shprehur interes për të qenë pjesë e Prokurorisë së Posaçme, si edhe është përfunduar dhe dorëzuar vlerësimi profesional i një kandidati për prokuror të përgjithshëm.

Nga ana e KLP-së, vijon puna për përgatitjen e raporteve të prokurorëve të prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, dhe të Apelit, të shortuara nga KPK.

2.5.4 Komisioni i Zhvillimit të Karrierës

Ky Komision shqyrton kërkesat për emërimë në prokurori sipas kriterëve të përcaktuara nga KLP, duke paraqitur një relacion para mbledhjes plenare, i cili shoqërohet me

¹³ Neni 84 dhe vijues i Ligjit Nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

dokumentacionin përkatës.

Gjithashtu, ky Komision shqyrton kërkesat e Shkollës së Magjistraturës për numrin e magjistratëve të rinj, emërimin dhe caktimin në pozicion të kandidatëve të diplomuar.

Emërimi dhe caktimi në detyrë i magjistratëve që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës, është një nga detyrimet që ka KLP. Kjo procedurë është parashikuar në Ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Në korrik të vitit 2018, kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës brezi i studentëve, të cilët nuk janë të emëruar dhe caktuar në prokurori. Nisur nga detyrimi, por dhe nga nevoja që ka emërimi i tyre, KLP menjëherë vendosi të fillojë procesin e emërimit të kandidatëve për magjistratë, duke kërkuar nga institucionet kompetente raportim për verifikimin e pasurisë dhe të figurës së kandidatëve, siç parashikohet në nenin 32, pika 2, të Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Emërimi përfundimtar i magjistratëve do të plotësojë një pjesë të vakancave në prokurori, të cilat kanë ardhur si pasojë e largimeve prej procesit të Vettingut, mbushjes së moshës së pensionit të disa prokurorëve, etj. Tashmë, KLP ka përfunduar procesin e emërimit dhe caktimit të 6 magjistratëve të rinj prokurorë në muajin korrik të vitit 2019, duke i caktuar ata në Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Kavajë, Krujë, Lezhë, Berat, Vlorë dhe Korçë.

Gjithashtu, KLP, duke analizuar nevojat dhe mundësitë që ka Shkolla e Magjistraturës, miratoi me Vendimin nr. 21, datë 28.01.2019, "Numrin e kandidatëve për t'u pranuar në programin fillestar të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2019-2020", përkatësisht, 25 pozicione për kandidatë për prokurorë.

Veprimtaria e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës ka qenë mjaft dinamike, edhe për shkak të fushës së veprimtarisë që mbulon, problematikave që dalin në vazhdimësi dhe nevojës për të dhënë opinione apo propozime nga ana e tij.

Gjatë kësaj periudhe, ky Komision ka qenë i angazhuar në hartimin e rregulloreve të ndryshme, si rregullorja e SPAK-ut, e Prokurorit të Përgjithshëm, rregullorja për caktimin e përkohshëm të prokurorëve etj.. Po kështu, objekt primar i veprimtarisë së këtij Komisioni ka qenë vlerësimi e situatave të krijuara si rezultat i shkarkimit të prokurorëve me vendim të KPK-së (nëpërmjet caktimit të përkohshëm në pozicionin e Drejtuesit, në 10 raste për periudhën janar-shtator 2019).

Nga një analizë e gjendjes aktuale të burimeve njerëzore (Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroritë e Apelit dhe Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë), rezulton situata si më poshtë:

Nga 29 zyra të Prokurorive të Apeleve dhe pranë Gjykatave të Shkallës së Parë rezultojnë se:

- a) 10 prokurorë janë të emëruar si drejtues, përkatësisht 6 drejtues pranë Gjykatave të Shkallës së Parë dhe 4 drejtues të Prokurorisë së Apeleve;

- b) 19 drejtues rezultojnë të caktuar përkohësisht në pozicionin e drejtuesit me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe me vendim të KLP-së. Nga këta, 8 Drejtues nuk e kanë emërimin pranë prokurorisë ku ushtrojnë detyrën e drejtuesit. Pjesa tjetër e kanë emërimin në prokurorinë pranë së cilës janë caktuar përkohësisht në pozicionin e drejtuesit.

32 prokurorë të tjerë janë të caktuar përkohësisht pranë:

- a) KLP-së (6 prokurorë);
- b) Prokurorisë së Përgjithshme (1 prokuror);
- c) Prokurorive të apeleve (3 prokurorë);
- ç) Prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë (22 prokurorë).

Nisur nga gjendja aktuale dhe nga domosdoshmëria për implementimin e ligjeve në kuadër të reformës në drejtësi, të ushtrimit të kompetencave të plota të KLP-së, të nevojës për sistemimin me magjistratë, të çdo pozicioni prokurori sipas organikave të miratuara, mirëadministrimit e strukturës drejtuese pranë cdo prokurorie sipas emërtesës, disiplinimit e punës në cdo rreth gjyqësor, dhe implementimin e kushteve të parashikuara në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”, nga ana e Komisionit të Karrierës është propozuar një plan veprimi se si do procedohet në lidhje me caktimet e përkohshme të krijuara si rezultat i dispozitave kalimtare.

Në rastin e caktimeve të përkohshme, KLP është treguar shumë i kujdesshëm në zbatimin e nenit 59, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke e zbatuar këtë dispozitë vetëm në ato raste kur caktimi i përkohshëm i një prokurori në cilësinë e Drejtuesit, apo të prokurorit të juridiksionit të përgjithshëm apo në nivel apeli, ka qenë domosdoshmëri. Për rrjedhojë, 13 Vendimet e KLP për caktimin e përkohshëm të prokurorit kanë ardhur si rezultat i një vendimmarrje të KPK-së.

2.6. Marrëdhëniet e KLP-së me Shkollën e Magjistraturës

Emërimi dhe caktimi në detyrë i magjistratëve prokurorë që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës, është një nga detyrimet që ka KLP-ja. Kjo procedurë është parashikuar në Ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në korrik të vitit 2018, kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës, brezi i studentëve, të cilët nuk janë të emëruar dhe caktuar në prokurori. Nisur nga detyrimi, por dhe nga nevoja që ka emërimi i tyre, KLP menjëherë, në mbledhjen e tij të tretë më datë 07.01.2019¹⁴, vendosi të fillojë procesin e emërimit të kandidatëve për magjistratë, të cilët janë diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2016, duke kërkuar nga institucionet kompetente raportim për verifikimin e pasurisë dhe të figurës së kandidatëve, siç parashikohet në nenin 32, pika 2 e Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

¹⁴ Vendim nr.10, datë 07.01.2019, , i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Emërimi përfundimtar i magistratëve do plotësojë një pjesë të vakancave në prokurori, të cilat kanë ardhur si pasojë e largimeve prej procesit të Vettingut, mbushjes së moshës së pensionit të disa prokurorëve, dorëheqjes, etj. Në përfundim të procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës për 6 magistratë të profilit prokurorë, KLP i emëroi në detyrë në datë 12.07.2019. Aktualisht, KLP është duke kryer verifikimet për 10 magistratë të profilit prokurorë të cilët kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës dhe emërimi i tyre është prioritet i punës në vijim. Paralelisht, po kryhet dhe verifikimi e pasurisë dhe të figurës së 25 kandidatëve që konkurojnë për t'u pranuar në Shkollën e Magjistraturës.

Gjithashtu, KLP, duke analizuar nevojat që sistemi ka dhe mundësitë që ka Shkolla e Magjistraturës, miratoi Vendimin " Për numrin e kandidatëve për t'u pranuar në programin fillestar të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2019-2020"¹⁵, përkatësisht 25 pozicione për kandidatë për magistratë prokurorë. Paralelisht po kryhet dhe verifikimi e pasurisë dhe të figurës së 25 kandidatëve që konkurojnë për tu pranuar në Shkollën e Magjistraturës.

Në vijim të detyrimeve që ka KLP, në mbështetje të neneve 14 dhe 33, të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", me anë të Vendimit nr. 45, datë 19.03.2019, "Për praktikën profesionale të kandidatëve për magistratë të Shkollës së Magjistraturës", KLP miratoi magistratët prokurorë udhëheqës për një periudhë trevjecare (2017-2020), me të drejtë riemërimi.

3 PROCESI I PËRZGJEDHJES SË PROKURORËVE PËR PROKURORINË E POSAÇME

3.1 Njoftimi dhe shpallja e vendeve vakante

Më datë 07.01.2019, KLP ka shpallur njoftimin për 15 vendet vakante për Prokurorinë e Posaçme. Duke qenë se brenda afatit të shpalljes nuk kishin aplikuar një numër i tillë kandidatësh që të mundëson të konkurrencën dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të mirë, KLP e shtyu afatin e aplikimit deri më 21.02.2019. Në përfundim të afatit, pranë KLP-së u regjistruan 28 aplikime për prokuror në Prokurorinë e Posaçme.

3.2 Procesi i hartimit dhe miratimit të Rregullores

Njëkohësisht me shpalljen e vendeve vakante, nisi puna për hartimin e Rregullores "Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar". Procesi i hartimit të Rregullores

¹⁵ Vendim nr. 21, datë 28.01.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

është mbështetur nga ekspertët e OPDAT dhe EURALIUS. Pas hartimit të projektregullores, iu nënshtrua diskutimit dhe konsultimit të detajuar, nga ana e të gjithë anëtarëve të KLP-së. Rregullorja është miratuar me Vendim nr. 51, datë 19.03.2019, të KLP-së dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 44, datë 29.03.2019. Në të njëjtën datë, rregullorja ka hyrë në fuqi.

3.3 Ngritja dhe përbërja e Komisionit të Posaçëm

Sipas nenit 11, të Rregullores, Komisioni i Posaçëm përbëhet nga 5 anëtarë të KLP-së, prej të cilëve 3 anëtarë prokurorë dhe 2 anëtarë jo prokurorë.

Anëtarët e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës janë ex-officio anëtarë të Komisionit të Posaçëm. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale përjashtohen ex-officio nga pjesëmarrja në Komisionin e Posaçëm.

Dy anëtarët e tjerë të Komisionit të Posaçëm, njëri prej të cilëve anëtar prokuror dhe tjetri anëtar jo prokuror, zgjidhen me short nga pjesa e mbetur e anëtarëve të KLP-së.

Në momentin e miratimit të Rregullores, për shkak të shkarkimit nga detyra e anëtares së Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Znj. Antoneta Sevdari, ky Komision kishte dy anëtarë (Z. Sandër Beci (jo prokuror) dhe Z. Arben Dollapaj (prokuror). Duke qenë se anëtari i ri i KLP-së ende nuk ishte zgjedhur, anëtar i Komisionit të Posaçëm do të ishte anëtari zëvendësues i Komisionit të Karrierës, Z. Bujar Sheshi (prokuror).

Për shkak të parashikimeve si më sipër në nenin 11 të Rregullores, anëtari i tretë prokuror i Komisionit të Posaçëm, automatikisht do të ishte z. Besnik Cani, i cili nuk kishte ndalim për të qenë në këtë Komision.

Anëtari i pestë (jo prokuror) i Komisionit do të caktohej me short mes anëtarëve të mbetur që nuk kishin ndalim për të qenë anëtar. Shorti është hedhur mes anëtarëve:

- Gent Ibrahimi
- Nurihan Seitaj
- Tartar Bazaj.

Pas zhvillimit publik të shortit, anëtar i Komisionit të Posaçëm u caktua z. Tartar Bazaj.

Përbërja e Komisionit të Posaçëm, caktuar sipas kriterëve dhe procedurës së pësipërme është:

1. Arben Dollapaj – prokuror
2. Besnik Cani – prokuror
3. Bujar Sheshi – prokuror
4. Sandër Beci – jo prokuror
5. Tartar Bazaj – jo prokuror

Z. Sandër Beci u caktua Kryetar i Komisionit të Posaçëm.

3.4 Verifikimi i plotësimi të kushteve ligjore nga ana e kandidatëve dhe miratimi i listës zyrtare

Komisioni i Posaçëm nisi veprimtarinë e tij me procesin e verifikimit të plotësimi të kushteve ligjore nga ana e kandidatëve të cilët kishin aplikuar për ngritjen në detyrë si prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme.

Në dt. 04.04.2019, Komisioni i Posaçëm, i përbërë nga:

Z. Sandër Beci	Kryetar
Z. Arben Dollapaj	Anëtar
Z. Bujar Sheshi	Anëtar
Z. Besnik Cani	Anëtar
Z. Tartar Bazaj	Anëtar

u mblodh në mbledhjen e tij të parë pas hyrjes në fuqi të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar”.

Sipas nenit 3, pika 1 të kësaj Rregulloreje, në këtë mbledhje Komisioni ka kryer vlerësimin paraprak të të gjithë kandidatëve për të përcaktuar nëse ata i plotësojnë kushtet ligjore për ngritjen në detyrë si prokuror në Prokurorinë e Posaçme.

Pranë Këshillit kanë ardhur 28 aplikime sipas njoftimit të bërë në faqen zyrtare të tij, më datë 07.01.2019.

Komisioni shqyrtoi secilin prej aplikimeve dhe verifikoi kushtet ligjore. Pas verifikimit paraprak, Komisioni vlerësoi se 25 kandidatë plotësojnë kushtet ligjore dhe mund të vazhdojnë procesin e vlerësimit të kriterëve të posaçme etike dhe profesionale.

Aplikanti Gëzim Cena nuk plotësonte kushtet ligjore për të vijuar garën. Konkretisht, nga studimi i dokumentacionit të paraqitur nga aplikanti, rezultoi të mos ketë qenë asnjëherë prokuror i Republikës së Shqipërisë, duke ardhur kështu në kundërshtim me nenin 47, pika 2 , gërma c, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit:

Për pozicionin prokuror në Prokurorinë e Posaçme, magjistrati duhet të këtë ushtruar funksionin për jo më pak se 10 vjet, duke përfshirë edhe përvojën si prokuror i komanduar.

Në këto kushte, Komisioni vlerësoi se aplikanti Gëzim Cena nuk mund të vijonte garën si kandidat për prokuror në Prokurorinë e Posaçme.

Për aplikantët Fatmir Hoxha dhe Irena Nino, Komisioni diskutoi rreth plotësimi të kushteve ligjore dhe vlerësoi se:

- Të dy kandidatët kanë qenë prokurorë të Republikës së Shqipërisë dhe secili prej tyre ka një vjetërsi mbi 10 vjet në sistemin e prokurorisë;
- Të dy kandidatët janë larguar nga sistemi me kërkesën e tyre.

Dispozitat tranzitore të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 166, parashikojnë mundësinë e ish-prokurorëve dhe kriteret që duhet të përmbushin ata për të rihyrë në sistemin e prokurorisë. Komisioni vlerësoi se, hyrja në sistemin e prokurorisë të ish-prokurorëve është një proces i ndryshëm nga ai i ngritjes në detyrë.

Sipas nenit 47, pika 1, gërma b), të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”:

“Ngritja në detyrë” është kalimi nga:

Një pozicion i juridiksionit të përgjithshëm civil, penal ose administrativ në një pozicion në një prej gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme.

Në këto kushte, Komisioni kërkoi interpretimin e KLP-së, lidhur me vlerësimin e plotësimin të kushteve ligjore të kandidatëve Fatmir Hoxha dhe Irena Nino.

KLP, në mbledhjen e tij të datës 5 prill 2019, mori në shqyrtim raportin e Komisionit të Posaçëm dhe me Vendimin nr. 57, datë 05.04.2019, miratoi listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore dhe mund të vijnë më vlerësimin e kriterëve profesionale dhe etike.

Aktualisht kjo listë ka pësuar ndryshimet e mëposhtme:

1. Z. Vatë Staka, më datë 11 prill 2019, zgjidhet anëtar i KLP-së nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve dhe duke filluar nga data 16 Prill 2019, po ushtron detyrën e re, e cila është e papajtueshme me atë të prokurorit gjatë viteve të ushtrimit të mandatit;
2. Z. Shkëlzen Cena, më datë 27.5.2019, ka paraqitur kërkesën për dorëheqje nga procesi i vlerësimin për prokuror pranë Prokurorisë së Posaçme, regjistruar me nr. 462 Prot., dhe Këshilli me Vendim nr. 57/1, datë 12.6.2019, ka vendosur ndërprerjen e garës për këtë kandidat;
3. Z. Eugen Beçi është shkarkuar nga detyra nga KPK-ja më datë 26.6.2019. Deri në përfundim të vlerësimin të këtij subjekti, ai konsiderohet i pezulluar dhe nuk vijon të ushtrojë detyrën e prokurorit. Për këtë shkak, KLP me vendim nr.118, datë 28.6.2019, ka vendosur pezullimin e garës për këtë kandidat.

Lista përfundimtare e kandidatëve për prokuror në Prokurorinë e Posaçme përmban 22 kandidatë.

3.5 Njoftimi dhe komunikimi me kandidatët zyrtarë

Komisioni i Posaçëm vendosi një komunikim zyrtar me kandidatët e shpallur nga KLP, duke u dërguar një shkresë zyrtare për të identifikuar punën e tyre në përputhje me Rregulloren sipas parashikimeve të nenit 11, pika 1 sipas të cilit:

Komisioni kërkoi nga kandidatët të identifikojnë produktin e punës së tyre dhe çështjet që mbështesin aplikimin e tyre, në përputhje me kriteret e renditura në

nenin 9. Kandidatët kanë 7 ditë kohë afat kohor për të identifikuar këto dokumente dhe për t'i vënë në dispozicion të Komisionit.

Nga ana e kandidatëve është kërkuar të vënë në dispozicion të Komisionit:

- a) Dosje ku të dokumentohet hetimi me sukses i çështjeve penale të ndërlikuara ligjërisht ose në fakte, përfshi përdorimin e metodave të avancuara të hetimit dhe qasjen proaktive, ose;
- b) Vendime gjykate në të cilat është dhënë vendim dënimi për korrupsion, krim të organizuar, pastrim parash, ose për çështje të tjera të ndërlikuara dhe ku të dokumentohet fakti që kanë qenë drejtues grupi hetimor, ose prokuror i vetëm dhe/ose kanë përfaqësuar prokurorinë në nivel apeli/Gjykatë të Lartë, ose;
- c) Vendime gjykate në të cilat është dhënë vendim dënimi për korrupsion, krim të organizuar, pastrim parash ose për çështje të tjera të ndërlikuara dhe ku të dokumentohet fakti se kanë qenë pjesë e një grupi prokurorësh në shkallë të parë ose në apel, ose;
- ç) Vendime gjykate, kërkesa për konfiskim ose çdo akt tjetër që dokumenton kërkimin me sukses nga ana tyre, të konfiskimit të pasurive që janë produkte të veprës penale ose të pasurive, në zbatim të ligjit antimafia.

3.6 Takimi me kandidatët dhe çështjet e diskutuara

Në takimin e mbajtur me kërkesë të Komisionit të Posacëm, ishin të pranishëm pjesa më e madhe e kandidatëve për prokuror të Prokurorisë së Posaçme. Në takim, veç anëtarëve të Komisionit, mori pjesë edhe Zëvendëskryetari i KLP-së, z. Alfred Balla si dhe përfaqësues të OPDAT dhe EURALIUS.

Takimi u fokusua kryesisht tek sqarimet lidhur me Rregulloren dhe dokumentacionin që duhet të paraqisnin kandidatët në vijim. Nga ana e të gjithë anëtarëve të Komisionit u sqarua procesi i vlerësimit të tyre dhe u kërkuar të vihen në dispozicion brenda afatit të përcaktuar në Rregullore, akte të procedimeve të ndryshme penale që do të dëshmonin kualifikimin e prokurorëve. Nga ana e prokurorëve kandidatë u kërkuar edhe një javë shtesë për paraqitjen e dokumentacionit, kërkesë që u miratua nga ana e Komisionit.

Nga disa kandidatë u shtrua për diskutim çështja nëse mund të sillnim për vlerësim akte të dosjeve që janë në hetim. Nga ana e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit u sqarua edhe njëherë fryma e Rregullores e cila, vlerësimin lidhur me aftësitë dhe kualifikimin e prokurorëve e bazon në çështje të përfunduara me vendim gjykate (edhe të shkallës së parë). Në përfundim të takimit u kërkuar që, kandidatët të mos sjellin për vlerësim akte të dosjeve të cilat janë ende në hetim.

Gjithashtu, u përsërit edhe njëherë ndalimi që buron nga Rregullorja, konkretisht, nga neni 21 i saj, lidhur me komunikimet jozyrtare mes kandidatëve dhe anëtarëve të Komisionit/Këshillit. Për këtë arsye, u kërkuar që kandidatët t'i paraqesin dokumentet e kërkuara pranë protokollit të KLP-së ose me postë.

Nga ana e Komisionit, kandidatëve iu kërkuar të shpreheshin për konfliktin e interesave mes tyre dhe anëtarëve të Komisionit dhe Këshillit, si organe që do të bënin vlerësimin e

tyre. Gjithashtu, u vu në dukje fakti që, Komisioni mund të kërkonte prej tyre sqarime ose dokumentacion shtesë. Për këtë qëllim, Komisioni krijoi një adresë zyrtare dedikuar komunikimeve me kandidatët.¹⁶

3.7 Metodologjia e miratuar me Urdhër të Kryetarit të Komisionit

Pas dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar nga kandidatët, Komisioni i Posaçëm filloi punën për vlerësimin e tyre, sipas kriterëve të parashikuara në nenin 9 dhe 10, të Rregullores.

Me Urdhër të Kryetarit të Komisionit të Posaçëm u miratua metodologjinë e punës së tij. Kjo metodologji përcakton miratimin e tabelave të vlerësimit paraprak të kandidatëve nga ana e anëtarëve të Komisionit, shortin për përpunimin fillestar të dokumentacionit dhe vlerësimin paraprak, tërheqjen e dokumentacionit të kandidatëve pranë protokollit të KLP-së, rishikimin e vlerësimit të parë të kryer nga një relator, rihedhjen e një shorti të dytë dhe qarkullimin e dokumentacionit dhe raporteve paraprake tek të gjithë anëtarët e Komisionit.

Gjithshtu, kjo metodologji përcaktonte edhe mënyrën e raportimit në Këshill, monitorimin e procesit të vlerësimit nga ana e OPDAT dhe EURALIUS, si dhe pjesëmarrjen e Kryetarit të Këshillit apo një përfaqësuesi të tij në mbledhjet e Komisionit.

3.8 Takimet e punës së Komisionit të Posaçëm

Në periudhën maj-qershor 2019, Komisioni ka zhvilluar një veprimtari intensive për vlerësimin e kandidatëve për prokuror në Prokurorinë e Posaçme.

Më datë 3 maj 2019, u zhvillua takimi i parë i Komisionit me përfaqësuesit e OPDAT dhe EURALIUS, ku janë diskutuar çështjet e mëposhtme:

- a) Arritja dhe artikulimi i metodave që janë në përputhje me njëra-tjetrën për vlerësimin e aplikimeve për SPAK;
- b) Pamje e përgjithshme e parimeve të vlerësimit;
- c) Identifikimi i materialeve që nevojiten për të shqyrtuar kriteret e parashikuara në Rregullore. Identifikimi i numrit të dosjeve të dorëzuara nga çdo aplikant dhe krijimi i një metode të përbashkët për përputhjen e rishikimit të dosjeve me kriteret e vlerësimit;
- ç) Diskutim për cilësitë e kandidatëve të suksesshëm. Identifikimi i cilësive kritike për suksesin e SPAK-ut. Sqarimi i objektivave, detyrave dhe përgjegjësive të SPAK-ut;
- d) Shqyrtimi i përkufizimeve dhe termave të parashikuara në Rregullore për të siguruar që Komisioni ka një kuptim të njëjtë të përkufizimeve;

¹⁶ Adresa e Komisionit: komisioniposacem@klp.al

dh) Përdorimi i tabelës së vlerësimit. Shqyrtimi i tabelës së vlerësimit paraparak në raport me Rregulloren për të siguruar që ajo i mbulon të gjitha kriteret e vlerësimit.

Më datën 13 maj 2019, Komisioni është mbledhur sërish me përfaqësuesit e OPDAT dhe EURALIUS dhe ka diskutuar çështjet e mëposhtme:

- a) Letrat e motivimit të kandidatëve dhe si ndihmojnë ato në procesin e vlerësimit;
- b) Identifikimi i dokumenteve të hartuara nga prokurorët, me qëllim vlerësimin konsistent prej anëtarëve të Komisionit, si p.sh., akt- akuzat, kërkesat për teknika hetimore, marrja në pyetje e dëshmitarëve, argumentet mbi dënimet, etj;
- c) Përdorimi gjatë procesit të vlerësimit i materialeve që vijnë nga burime të tjera informacioni, siç janë artikujt/ kronikat e Medias;
- ç) Kërkesa në KLP për shtyrjen e afateve kohore.

Më datë 20 Maj 2019, Komisioni realizoi një mbledhje të tretë me përfaqësuesit e OPDAT dhe EURALIUS, ku u diskutuan çështjet si më poshtë:

- a) Dokumenti nga i cili duhet të fillojë vlerësimi i kandidatëve;
- b) Metodologjia e vlerësimit;
- c) Diskutimi në Komision dhe vendimmarrja e Komisionit si organ kolegjal.

Më datë 08.07.2019, është realizuar procesi i intervistimit të kandidatëve, në prani të përfaqësuesve të OPDAT dhe EURALIUS, proces i cili përfundoi më 12.07.2019.

Më datë 16.07.2019, Komisioni miratoi listën me 15 kandidatë për prokuror në Prokurorinë e Posaçme. KLP, është në pritje të vendimeve që do të marrë KPK për rivlerësimin kalimtar të këtyre kandidatëve. Aktualisht, 5 kandidatë janë konfirmuar në detyrë edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, 3 kandidatë janë duke pritur që vendimi i konfirmimit në detyrë nga KPK të mos ankimohet dhe të marrë formë të prerë, ndërsa 7 kandidatë të tjerë nuk i janë nënshtruar ende procesit të rivlerësimit kalimtar nga KPK.

3.9 Mënyra e vlerësimit të kandidatëve sipas nenit 9, të Rregullores

Sipas nenit 9, pika 1, të Rregullores:

1. Kandidati vlerësohet me “Kualifikim të lartë” për këtë kriter kur verifikohet një nga faktet e mëposhtme:
 - a) ka hetuar me sukses jo më pak se pesë çështje penale të ndërlikuara ligjërisht ose në fakte, përfshi përdorimin e metodave të avancuara të hetimit dhe qasjen proaktive;
 - b) ka qenë drejtues grupi hetimor ose prokuror i vetëm dhe/ose ka përfaqësuar prokurorinë në nivel apeli/Gjykatë të Lartë, në jo më pak se pesë procese gjyqësore për të cilat është dhënë vendim dënimi për korrupsion, krim të organizuar, pastrim parash ose për çështje të tjera të ndërlikuara;
 - c) ka qenë pjesë e një grupi prokurorësh, në shkallë të parë ose në nivel apeli, në jo më pak se dhjetë procese gjyqësore, në të cilat është dhënë vendim dënimi për

korrupsion, krim të organizuar, pastrim parash, ose për çështje të tjera të ndërlikuara;

ç) ka kërkuar me sukses konfiskimin e pasurive të cilat janë produkte të veprës penale në jo më pak se pesë raste dhe/ose kur vlera e aseteve të konfiskuara ka qenë e lartë ose ka kërkuar me sukses konfiskimin e pasurive në zbatim të ligjit antimafia në jo më pak se pesë raste dhe/ose kur vlera e aseteve të konfiskuara ka qenë e lartë.

Për të kryer vlerësimin, Komisioni ka analizuar elementë të veçantë të akteve të procedimeve penale të paraqitura nga kandidatët.

Së pari, është bërë vlerësimi nëse çështja është e ndërlikuar ligjërisht dhe në fakte. Referimi kryesor është neni 2/k, i Rregullores ku jepet përkufizimi përkatës:

“Çështje të ndërlikuara ligjërisht dhe në fakte” konsiderohen ato çështje ku subjekt i hetimit është një funksionar i lartë publik, të cilat kanë një numër të madh të pandehurish ose një numër të madh veprash penale, që passjellin pasoja të rënda për jetën dhe pasurinë e personave ose shkaktojnë dëm të madh ekonomik, të cilat rezultojnë në konfiskimin e aseteve me vlera të mëdha etj.

Në vlerësimin e çështjes merren parasysh:

- a) Subjekti i hetimit: nëse është **funksionar i lartë** apo jo. Në këtë rast, Komisioni ka mbajtur qëndrimin se edhe gjyqtarët, prokurorët dhe funksionarët e tjerë të sistemit të drejtësisë janë funksionarë të lartë;
- b) Numri i të pandehurve: numër i lartë të pandehurish Komisioni ka vlerësuar **kur janë 3 të pandehur ose më shumë;**
- c) Numër i madh veprash penale: Komisioni ka vlerësuar që **numër i madh veprash penale do të jenë 3 ose më shumë;**
- ç) Pasoja të rënda për jetën dhe pasurinë e personave: Interpretimi ka qenë rast pas rasti si, rastet e vrasjeve, plagosjeve, trafikimit, shfrytëzimit për prostitucion, vjedhjeve, etj;
- d) Dëm i madh ekonomik: Komisioni ka vlerësuar rastet e vjedhjeve të bankave, mashtrime në shuma të mëdha etj dhe i ka shqyrtuar rast për rast;
- dh) Konfiskimi i aseteve: kjo çështje është parë edhe nën këndvështrimin e vlerësimit të një çështjeje si e ndërlikuar ligjërisht dhe në fakte, ashtu edhe nën këndvështrimin e nenit 9, pika 1, gërma ç, e Rregullores, ku kualifikimi i kandidatit matet me rastet e konfiskimeve.

Së dyti, Komisioni ka vlerësuar përdorimin e metodave të avancuara të hetimit dhe qasjen proaktive. Edhe në këtë rast referimi është tek neni 2, gërma j, e Rregullores, sipas të cilës:

“Teknikat e posaçme të hetimit” janë metodat speciale të hetimit sipas Kodit të Procedurës Penale dhe parashikimeve të tjera ligjore, përdorimi i të cilave nuk është i autorizuar për të gjitha llojet e veprave penale, të tilla si veprimet simuluese, infiltrimi në përbërje të grupit kriminal, dorëzimi i kontrolluar, mbrojtja e dëshmitarit, si dhe teknika të tjera si vendimet për kontroll në rastet e hetimeve të veprave penale të korrupsionit, sigurimi me anë të letërporosisë i

provave që gjenden jashtë vendit, sigurimi i provave kompjuterike, përdorimi i provave mjekoligjore, si: ADN, përdorimi i ekspertizës kontabël, përgjimi elektronik, marrja dhe përdorimi i informacioneve nga vende të huaja, provat kompjuterike, përdorimi i bashkëpunëtorëve të drejtësisë ose bashkëpunimi në marrëveshjet e fajësisë, etj.

Nga anëtarët e Komisionit janë evidentuar për çdo çështje përdorimi i një apo disa metodave të posaçme të hetimit. Gjithashtu, sa i përket qasjes proaktive, referimi ka qenë neni 2, gërma I, i Rregullores sipas të cilës:

“Hetim proaktiv” është ai hetim ku procesi i mbledhjes së provave kryhet njëkohësisht me lindjen e dyshimit për kryerjen e veprës së dyshuar penale, si dhe hetimet që nisen nga prokurori në mungesë të një kallëzimi, ose çdo hetim i cili është dukshëm më i zgjeruar se kallëzimi origjinal.

Në varësi të të dhënave të përfuara nga studimi i dosjeve, është arritur në përfundimet përkatëse nëse janë zhvilluar hetime proaktive apo jo, si dhe nëse janë përdorur metoda të posaçme të hetimit.

Së treti, Komisioni ka diskutuar gjatë lidhur me konceptin “Hetim i suksesshëm”, i cili i referohet nenit 2, gërma II, të Rregullores sipas të cilës:

“Hetim i suksesshëm” është çdo procedim i dërguar për gjykim në përfundim të të cilit është marrë fajësi, ose kur prokurori tregon se veprimet hetimore kanë qenë shteruese pavarësisht vendimit të gjykatës.

Në Komision janë zhvilluar debatet lidhur me faktin se, në cilën fazë do të konsiderohet i suksesshëm hetimi.

Gjatë shqyrtimit të dosjeve ka patur tre tipologji aktesh si vijon:

- a) Akte të procedimeve penale që ende janë në hetim (Komisioni nuk i ka marrë në vlerësim);
- b) Akte të procedimeve penale që janë dërguar në Gjykatë dhe gjyqtari i seancës paraprake ka vendosur t’i dërgojë për gjykim (për këto akte, Komisioni zhvilloi debat dhe kërkoi interpretimin e KLP-së, i cili vlerësoi se, aktet e kësaj kategorie procedimesh penale, që ende nuk janë gjykuar në themel të mos vlerësohen);
- c) Akte të procedimeve penale që janë gjykuar dhe tashmë kemi vendim gjykate, të paktën të shkallës së parë.

Diskutimi tjetër për këto çështje lidhet me vendimin e gjykatës. Sipas Rregullores, jo domosdoshmërisht kërkohet vendimi që jep fajësi. Mund të ndodhë që, pavarësisht vendimit të gjykatës, prokurori të ketë kryer veprime dhe hetime shteruese. Këto raste kanë qenë të rralla për diskutim.

Në përfundim të analizës së mësipërme është bërë vlerësimi sasior: 5 çështje, 3-5 çështje ose më pak se 3 çështje për të gjykuar mbi kualifikimin e kandidatit.

3.10 Mënyra e vlerësimit të kandidatëve sipas nenit 10 të Rregullores

Parimi kryesor për vlerësimin e kandidatëve sipas nenit 10 (qëndrueshmëria, vendosmëria integriteti), të Rregullores ka qenë starti i barabartë për të gjithë kandidatët dhe vlerësimi nga shkalla më e ulët e vlerësimit (kualifikim i ulët) drejt shkallës më të lartë (kualifikim i lartë).

Në vlerësimin e kandidatëve është marrë parasysh si kriter, përshkrimi nga ana e kandidatit, i rrethanave ku tregohen situatat me presion, rreziqet e përballuara, kërcënimet, etj.

Duke qenë se jo të gjithë kandidatët kanë sjellë materiale ku të përshkruajnë situatat e mësipërme, Komisioni ka vlerësuar edhe:

- a) Situata të cilat rrjedhin nga çështjet që kandidati ka sjellë për vlerësim sipas nenit 9, të Rregullores;
- b) Karakteri i çështjes, shkalla e vështirësisë së saj, numri i të pandehurve, rrezikshmëria shoqërore e veprës penale dhe e subjekteve;
- c) Numri dhe lloji i personave të hetuar dhe të dënuar. Në këtë rast, Komisioni ka vlerësuar rastet e hetimit dhe dënimit për korrupsion të zyrtarëve të lartë duke përfshihen ministra dhe funksionarë të lartë të ekzekutivit apo gjyqtarë, prokurorë dhe funksionarë të tjerë të drejtësisë.

3.11 Mënyra e vlerësimit të kandidatëve sipas nenit 5 dhe 6, të Rregullores

Në nenin 5, të Rregullores parashikohet se:

Kriteri i vlerësimit të performancës të kandidatëve përfshin dy vlerësimet e fundit të performancës së kandidatit.

Duke qenë se organi që ka bërë vlerësimin e prokurorëve ka qenë Prokuroria e Përgjithshme, KLP i është drejtuar me një kërkesë për informacion këtij institucioni për t'u njohur me dy vlerësimet e fundit, për vitet 2015-2016, për kandidatët për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme.

Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar pranë KLP-së informacionin e kërkuar. Sipas saj rezulton se, të gjithë kandidatët për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme janë vlerësuar me **shumë mirë**, në dy vlerësimet e fundit.

Sipas nenit 6, pika a), të Rregullores, vlerësimi me pikë për kandidatët që kanë dy vlerësimet e fundit **shumë mirë** është 5 pikë.

Ky rezultat është pasqyruar në Formularin nr. 2, si aneks i Rregullores dhe u është shpërndarë anëtarëve të KLP-së.

3.12 Dokumentacioni i administruar nga Komisioni

Komisioni gjatë punës së tij për vlerësimin e kandidatëve ka administruar dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Letrat e motivimit të kandidatëve. Të gjithë kandidatëve u është kërkuar që në momentin e shprehjes së interesit, të paraqesin para KLP-së letrën e motivimit, nëpërmjet të cilës Komisioni ka kryer vlerësimet e veta lidhur me nenin 10, të Rregullores;
- b) Akte të procedimeve penale dhe procedimeve pasurore të sjella nga vetë kandidatët. Vetë Rregullorja parashikon që, janë kandidatët ata që vetëofrohen për vlerësim. Kandidatëve u është kërkuar të sjellin akte të procedimeve penale e pasurore ku të dëshmojnë aftësitë e tyre në hetim, ndjekjen penale, përfaqësim në gjykatë etj., nëpërmjet dosjeve që ata dëshirojnë. Në këtë proces, Komisioni ka administruar një volum të madh aktesh që përfshijnë kërkesa për gjykim, konkluzione përfundimtare, vendime gjykate, vendime për masa sigurimi (personal dhe pasuror), etj. Në total, Komisioni ka administruar akte të mbi 400 (katërqind) procedimeve penale dhe pasurore;
- c) Akte të procedimeve penale të kërkuara nga anëtarët e Komisionit. Gjatë vlerësimit të dosjeve të kandidatëve, anëtarët e Komisionit kanë patur pyetje të ndryshme lidhur me ecurinë e procedimeve penale të prezantuara nga kandidatët. Për të arritur në një vlerësim sa më objektiv dhe të saktë, Komisioni, nëpërmjet e-mailit zyrtar ose me shkresë zyrtare, u ka kërkuar kandidatëve apo prokurorive ku ata ushtrojnë detyrën, akte të procedimeve penale për të cilat ka patur pyetje apo paqartësi;
- ç) Informacione nga burime të hapura. Sipas pikës 5, të nenit 9, të Rregullores, *Komisioni shqyrton gjithashtu edhe çdo çështje tjetër të hetuar nga kandidati gjatë karrierës së tij e cila ka tërhequr vëmendjen e opinionit publik.* Lidhur me këtë parashikim, Komisioni ka shqyrtuar informacione të cilat vinin nga burime të tjera, përtej dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Pas një diskutimi lidhur me këto informacione, Komisioni ka kërkuar në prokuroritë ku kandidatët ushtrojnë ose kanë ushtruar detyrën, akte të procedimeve penale dhe dosje të plota të procedimeve penale për kandidatët për të cilët ka patur informacione të tilla.

3.13 Vlerësimi përfundimtar i Komisionit dhe KLP-së

Pas një pune intensive dhe diskutimeve të gjata, Komisioni ka bërë vlerësimin e lidhur me kualifikimin e kandidatëve sipas kritereve të parashikuara Rregullore.

Me Vendimin nr. 137, datë 16.7.2019, KLP vendosi të miratojë listën me renditjen e kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme.

KLP është në pritje të përfundimit të procesit të rivlerësimit për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme për të vijuar më tej, me ngritjen e Prokurorisë së Posaçme dhe emërimin e prokurorëve të kësaj prokurorie.

4. PROCESI I PËRZGJEDHJES SË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

4.1 Njoftimi dhe shpallja e vendeve vakante

KLP, me Vendimin nr. 50, datë 19.03.2019, miratoi Rregulloren “Për kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë”, e cila është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 44, datë 29.03.2019 dhe ka hyrë në fuqi në të njëjtën datë.

Procesi i hartimit të Rregullores është mbështetur nga ekspertët e OPDAT dhe EURALIUS dhe i është nënshtruar diskutimit dhe konsultimit të detajuar nga ana e të gjithë anëtarëve të Këshillit.

Me hyrjen në fuqi të Rregullores, më datë 29.03.2019, KLP ka shpallur njoftimin për shprehjen e interesit për pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë. Në përfundim të afatit 30 ditor, pranë KLP-së u regjistruan 4 (katër) kandidatë që shprehen interesin për këtë pozicion dhe më datë 29.04.2019, KLP publikoi në faqen e tij zyrtare emrat e kandidatëve, konkretisht:

- Znj. Arta Marku
- Znj. Fatjona Memcaj
- Z. Lulzim Alushaj
- Z. Olsian Çela

4.2 Afatet e verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore nga ana e kandidatëve

Bazuar në nenin 3, pika 4, të Rregullores së lartpërmendur, KLP, brenda 45 ditëve nga përfundimi i afatit të dorëzimit të shprehjes së interesit nga kandidatët, kryen verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore që duhet të plotësojnë kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm, bazuar në përcaktimet e nenit 22, të Ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” si dhe të nenit 4, të Rregullores “Për kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë”.

Gjithashtu, në përcaktimet ligjore të sipërcituara përcaktohet se, KLP pret përfundimin e procedurave të rivlerësimit për kandidatët që i nënshtrohen këtij procesi deri në konfirmimin e tyre. Me Shkresën nr. 397, datë 08.05.2019, KLP i është drejtuar zyrtarisht KPK-së, për të mundësuar rivlerësimin me përparësi të kandidatit Z. Olsian Çela.

Sa më sipër, nisur nga fakti që, pavarësisht shkresës së lartpërmendur, procesi i rivlerësimit për kandidatin Z. Olsian Çela nuk kishte përfunduar brenda afatit 45 ditor që duhej të përfundonte procesi i verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore nga kandidatët, KLP, me Vendimin nr. 109, dt. 17.06.2019, vendosi të shtyjë afatin për verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore nga kandidatët në garë, deri në përfundimin e këtij procesi për kandidatin Z. Olsian Çela.

Po në këtë vendim, Këshilli vendosi që, Kryetari i KLP-së të caktojë një grup pune për administrimin e dokumentacionit të paraqitur si nga kandidatët dhe nga institucionet në

kuadër të vlerësimit të kandidatëve. Me Urdhrin nr. 32, datë 18.06.2019, të Kryetarit të KLP-së, u caktua grupi i punës i përbërë nga:

- Z. Kosta Beluri;
- Znj. Nurihan Seiti;
- Z. Vatë Staka.

4.3 Kërkimi i informacionit për verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore nga ana e kandidatëve

Me publikimin e emrave të kandidatëve në faqen zyrtare të KLP-së, Këshilli bazuar në nenin 31, të Ligjit 97/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 4 dhe 14 të Rregullores, vijoi procedurën me dërgimin e kërkesave zyrtare për informacion institucioneve publike dhe private, Shërbimit Informativ Shtetëror, Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, DSIK-ut dhe Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktin e Interesit, për informacione të lidhura me kandidatët.

Këtë informacion, Këshilli e kërkoi si për kandidatin Lulzim Alushaj, i cili nuk është subjekt i ligjit për rivlerësimin kalimtar, ashtu edhe për tre kandidatët e tjerë, lidhur me informacione që mund të dispononin për fakte të ndodhura pas vendimit të organeve të rivlerësimit. Institucionet i janë përgjigjur kërkesës së KLP-së duke përcjellë informacionin që ata dispononin për kandidatët.

Grupi i punës i ngritur me urdhrin e Kryetarit të KLP-së, gjatë administrimit të dokumentacionit të kandidatëve në garë, gjykoj se duhet t’i kërkohej dokumentacion shtesë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve lidhur me kandidatin Lulzim Alushaj. KLP, me Vendimin nr. 121, datë 05.07.2019, vendosi t’i drejtohet institucionit në fjalë për të kërkuar informacion shtesë për kandidatin. Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve i është përgjigjur kërkesës së KLP-së brenda 12 ditëve me shkresën nr. 13683/1, datë 23.07.2019.

Në këtë moment, me administrimin e dokumenteve të dorëzuara nga kandidatët, si dhe me informacionin zyrtar të mbërritur nga institucionet të cilave u ishim drejtuar, KLP nuk ndërmori veprime të mëtejshme për vlerësimin paraprak me qëllim verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore, deri në pritje të përfundimit të procedurave ligjore të rivlerësimit të njërit prej kandidatëve, Z. Olsian Çela.

KONKLUZIONE

Në zbatim të detyrimeve ligjore që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe kuadri ligjor përkatës për reformën në drejtësi, KLP është marrë me aktivitete të natyrave të ndryshme, duke nisur nga hartimi i akteve me karakter të brendshëm rregullues, akteve me karakter nënligjor dhe ngritjes së strukturave të posaçme në mbështetje të institucionit, ashtu sikurse të strukturave të tjera që duhet të ngriheshin për shkak të ligjit.

KLP, për periudhën dhjetor 2018- korrik 2019, është hasur me vështirësi dhe sfida të mëdha, për kryerjen e detyrave funksionale të tij, si: mungesa e burimeve njerëzore dhe vështirësitë infrastrukturore nga njëra anë, ashtu sikurse mungesa e bazës ligjore për të bërë sa më efektiv ligjin nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe ligjin nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Një sfidë më vete për KLP ishte dhe hartimi i akteve dhe ngritja e mirëfilltë e strukturave përgjegjëse për shqyrtimin e karrierës së prokurorëve (karrierë e cila përfshin që nga kandidimi për magistratë në Shkollën e Magistraturës, tek kandidimi për prokurorë, apo tek ata që kanë dalë nga sistemi i Prokurorisë dhe kërkojnë të rikthehen në karrierën e prokurorit, ashtu sikurse procedura e ngritjes në detyrë të këtyre të fundit).

Gjithashtu, KLP, në ushtrim të kompetencave të tij, ka patur dhe vazhdon të ketë në fokus të veçantë, krijimin e Prokurorisë së Posaçme, si një prej detyrimeve ligjore më të rëndësishme për luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, në vëmendje jo vetëm të institucioneve ligjzbatuese në vend, por edhe të faktorit ndërkombëtar. Për të arritur rezultate të prekshme dhe me efekte që priten të vijnë shpejt, KLP miratoi gjithashtu Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar”, ashtu sikurse ngriti një Komision të Posaçëm për vlerësimin e kandidatëve për Prokurorinë e Posaçme dhe ku ky i fundit miratoi “Metodologjinë e punës së Komisionit të Posaçëm për vlerësimin e kandidatëve për Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar”.

Në kuadër të detyrimeve që rrjedhin nga ligjet e posaçme, një prej veprimtarive të suksesshme të këtij institucioni është edhe shpallja e fillimit të procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm, bazuar në Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm”, të miratuar nga KLP.

Zgjedhja e Prokurorit të Përgjithshëm është një procedurë e vështirë, që kërkon jo vetëm kohën e duhur, por njëkohësisht edhe koordinimin me struktura të tjera. Pavarësisht kësaj, mund të themi se KLP deri më sot, ka zbatuar rigorozisht afatet dhe detyrimet ligjore që i takojnë dhe mund të konsiderojmë se, kjo detyrë është realizuar shumë mirë deri në këtë fazë të procedurës.

Për këtë, KLP ka miratuar Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë”, me qëllim që

përzgjedhja, renditja dhe propozimi i tre kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm të kryhet përmes një procesi objektiv, transparent, dhe gjithëpërfshirës.

Ndër sfidat me të cilat është hasur KLP, mund të përmendim vakuumin e krijuar në sistemin e drejtimit në prokuroritë si pasojë e shkarkimit të drejtuesve të prokurorive gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.

Njëkohësisht, disa nga veprimtaritë e tjera me efekte të menjëhershme dhe me rezultate të dukshme, janë rregulloret e hartuara dhe miratuara nga KLP, si:

- a) Rregullorja “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”;
- b) Rregullorja “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve” ;
- c) Rregullorja “Për vlerësimin etik dhe profesional të subjekteve në procesin e rivlerësimit”;
- d) Rregullorja “Për pagesat e prokurorëve për punën e kryer jashtë orarit zyrtar”, si dhe rregullat për kryerjen e praktikës profesionale të kandidatëve për magistratë të Shkollës së Magjistraturës.

Në vijim, priten të miratohen edhe disa Rregullore të tjera, po aq të rëndësishme sa ato të sipërpërmendura, për të cilat ka përfunduar procesi i hartimit dhe po ndiqen procedurat e konsultimeve paraprake, përpara miratimit në Këshill.

Sa më sipër, dhe në përfundim të këtij raporti, mund të konstatojmë se, KLP dhe komisionet e ngritura pranë tij (të përhershëm, të përkohshëm dhe *ad hoc*) gjatë periudhës së raportimit, kanë kryer një veprimtari intensive dhe kanë realizuar detyrimet ligjore me rezultate të kënaqshme.

KLP do të vijojë aktivitetin e tij bazuar në ligj, me vullnetin e plotë për të realizuar detyrimet ligjore në mënyre eficiente dhe efektive, ashtu sikurse do të ketë në vëmendje edhe përmirësimin e veprimtarisë për aspekte, për të cilat janë shfaqur problematika të caktuara gjatë punës.